

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

## **KONKURS**

për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe në thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale artistike në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe në thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale artistike në Universitetin e Tetovës:

### **FAKULTETI JURIDIK**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - E drejta tregtare
  - E drejta detyrimore
  - Legjislacioni në arsim
2. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Hyrje në shkencat politike
  - Analiza e politikës së jashtme.

### **FAKULTETI EKONOMIK**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Bankat dhe punët bankare
  - Financat e korporatave.
2. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Marketingu ndërkombëtar
  - Marketingu strategjik
  - Sjellje konsumatore.
3. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Mikroekonomi
  - Ekonometri.

### **FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE**

1. Një mësimdhënës për lëndën:
  - Gjimnastika sportive.

### **FAKULTETI I ARTEVE**

1. Një mësimdhënës për lëndët profesionale-artistike:
  - Teknikat e pikturës 1 dhe 2
  - Pikturë monumentale 1 dhe 2.
2. Një mësimdhënës për lëndët profesionale-artistike:
  - Harmonia 1, 2, 3 dhe 4
  - Harmonia vokale instrumentale 1 dhe 2.
3. Një mësimdhënës për lëndët profesionale-artistike:
  - Forma muzikore 1, 2, 3 dhe 4
  - Analizë stilistike 1, 2, 3 dhe 4
  - Lexim partiturash.
4. Një mësimdhënës për lëndët profesionale-artistike:
  - Aktrim
  - Aktrim intermedial.

**Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

**Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore në lëndët profesionale-artistike docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e magistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore dhe në thirrje mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike, të parapara me nenet 166 dhe 167 të Ligjit për arsimin e lartë.

\*Fletëparaqtjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Universiteti i Tetovës**